



Bazuar në nenin 8, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/14 korrik 2011) dhe nenin 1 paragrafi 5 të Rregullores për zbatimin e sistemit bonus-malus të miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës me 12 qershor 2020,

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Byrosë Kosovare të Sigurimit në mbledhjen e mbajtur me 13.10.2020, miratoi këtë

## UDHËZIM

### MBI IMPLEMENTIMIN E SISTEMIT BONUS-MALUS PËR PERSONA JURIDIK

#### Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Ky udhëzim përcakton mënyrën e aplikimit dhe përllogaritjes së primit në implementimin e sistemit bonus-malus për personat juridik, sipas nenit 1 paragrafi 5 të rregullores për zbatimin e sistemit bonus-malus, të miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës.
2. Ky udhëzim aplikohet nga të gjitha kompanitë e sigurimit në Kosovë, të licencuara për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

#### Neni 2 Përkufizimet

1. Sistemi bonus-malus është sistem i cili zbatohet si korrektues i lartësisë së primit të sigurimit të autopërgjegjësisë, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit.
2. Automjete në lizing – janë mjetet motorike të cilat janë në pronësi të personit juridik – lizingdhënësi, ndërsa në përdorim të personit tjetër fizik apo juridik – lizingmarrësi, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Automjetet zyrtare – janë mjetet motorike të cilat janë në pronësi të institucioneve shtetërore dhe publike të Republikës së Kosovës.
4. Automjetet tjera – janë mjetet motorike të cilat janë në pronësi të subjekteve – personave juridik privat.
5. Automjetet në pronësi publiko-private janë mjetet motorike të cilat janë në pronësi të subjekteve juridike, në pronësi të subjektit publik ose privat prej mbi 50% të pronësisë.
6. Të dhënat si emërtimi i biznesit, numri i unik identifikues, numri i regjistrimit të biznesit, numri fiskal dhe numri i TVSH-së, numri i regjistrimit si OJQ, të subjektit juridik do të jenë bazë për aplikimin e sistemit bonus-malus
7. Kontraktuesi i Sigurimit – Personi fizik ose juridik, i cili nënshkruan marrëveshje mbi sigurimin
8. I siguruari – Personi interes i pasuror i të cilit është siguruar në rast të përgjegjësisë nga posedimi dhe përdorimi i mjetit motorik.

- Vonesa në renovimin e sigurimit nga autopërgjegjësia – paraqet numrin e ditëve të kaluara nga skadimi i sigurimit paraprak deri tek kontraktimi i sigurimit të ri për një veturë të caktuar, dhe matet në ditë.
- Termat tjerë të përdorur në këtë udhëzim kanë kuptim të njëjtë siç përcaktohen në Ligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

### Neni 3 Bonusi dhe Malusi

- Secilit të siguruar në Kosovë, që ka kontratën (policën) e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia me afat të paktën një vit, niveli i premisë i caktohet sipas sistemit bonus-malus, përkatësisht sipas shkallëve të premisë, varësisht nga fakti nëse në periudhën e kaluar të sigurimit (vëzhgimit) ka pasur dëme të deklaruara apo jo.
- Për qëllime të kësaj rregullore, dëm i deklaruar quhet dëmi sipas të cilit është kryer pagesa ose është përcaktuar detyrimi i siguruesit (dëmi është raportuar).
- Periudha e vëzhgimit zgjat 1 vit dhe fillon të zbatohet nga 01.07.2012.
- Llogaritje e primit sipas sistemit bonus-malus fillon të zbatohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për dëmet e ndodhura gjatë periudhës vëzhguese.
- Kur i siguruari lidh sigurimin për automjet për herë të parë, paguan preminë e shkallës themelore njëmbëdhjetë (11) të përcaktuar nga paragrafi 8 i këtij nenit.
- Nëse mjeti motorik ka qenë i siguruar të paktën një vit dhe nëse në periudhën e vëzhgimit nuk ka pasur dëme të deklaruara, të njëjtit për vitin pasardhës i lejohet një shkallë premie më e ulët, por jo më shumë se deri në shkallën e parë (1) të përcaktuar me paragrafin 8 të këtij nenit.
- Për çdo dëm të paraqitur në periudhën e vëzhgimit pavarësisht nga kohëzgjatja e sigurimit, mjeti motorik zhvendoset për vitin e ardhshëm të sigurimit për tre (3) shkallë premie më lart, por jo më shumë se deri te shkalla e nëntëmbëdhjetë (19) të përcaktuar me paragrafin 8 të këtij nenit.
- Shkallët e premisë në përqindje që nga shkalla themelore e premisë 11 (100%) janë këto:

Shkalla	Perqindja	Shkalla	Perqindja
1	45%	11	100%
2	50%	12	110%
3	55%	13	120%
4	60%	14	135%
5	65%	15	150%
6	70%	16	175%
7	75%	17	200%
8	80%	18	225%
9	85%	19	250%
10	90%		

- Në rastin kur mjeti motorik është në pronësi prej mbi 50% të subjektit publik, për të njëtin do të aplikohen dispozitat e kësaj rregulloreje sikurse për automjetet zyrtare.
- Në rastin kur mjeti motorik është në pronësi prej mbi 50% të subjektit privat, për të njëtin do të aplikohen dispozitat e kësaj rregulloreje sikurse për automjetet tjera.

**Neni 4**  
**Rregulla tjera për bonusin dhe malusin**

1. E drejta për një shkallë të caktuar të premisë (bonus-malus) lidhet me mjetin motorik, përkatësisht përdoruesin-vozitësin e automjetit dhe nuk kalon te pronari i ri.
2. Në rast të kalimit të pronësisë së mjetit motorik nga Lizingu në shfrytëzuesin e të njëjtë mjet motorik, shkallët e Bonusit do të barten në pronarin e ri, përveç nëse nuk ka shkaktuar ndonjë dëm.
3. Bonusi dhe malusi aplikohet në të gjitha kategoritë e automjeteve të cilat sigurohen me polica të sigurimit të detyrueshëm dhe përfshinë personat juridik.
4. Siguruesi i pranon të siguruarit shkallën e arritur të premisë në bazë të informacioneve të gjeneruara nga Qendra Informative e Sigurimeve që administrohet nga Byroja Kosovare e Sigurimeve apo informacione nga subjekte tjera të pranueshme për BQK-në.
5. Personi juridik ka të drejtë në shkallën e bonusit, vetëm për ato automjete për të cilat nuk është raportuar dëm, ndërsa do të aplikohet shkalla përkatëse e malusit për automjetet për të cilat është raportuar dëmi, sipas nenit 3 paragrafi 8 të këtij udhëzimi.
6. Nëse i siguruari ka lidhur kontratë sigurimi me afat më të shkurtër se një vit, ajo kontratë në vitin pasardhës nuk mund të jetë bazë për uljen e shkallës së premisë edhe pse nuk ka pasur dëm të deklaruar gjatë asaj periudhe, por nëse është deklaruar dëm, kjo kontratë merret si bazë për ngritjen e shkallës së premisë.
7. Kompania e Sigurimit humb të drejtën për të arkëtuar premi të shkallës më të lartë (malus), nëse këtë të drejtë nuk e ka shfrytëzuar brenda tre viteve pas deklarimit të dëmit sipas bazës me të cilën e ka fituar këtë të drejtë.
8. Aplikimi i siguruesve në tender për automjetet shtetërore dhe publike, do të bëhet sipas shkallës 11 (100%) të premisë së sistemit bonus-malus.
9. Kontraktimi i sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për automjetet zyrtare shtetërore dhe publike, bëhet sipas shkallës 11 (100%) të premisë së sigurimit.
10. Dispozitat për bonus-malus të përcaktuara me nenin 3, paragrafi 8 të këtij udhëzimi, nuk aplikohen edhe për automjetet zyrtare shtetërore dhe publike.
11. Dispozitat për bonus-malus të përcaktuara me këtë rregullore aplikohen për automjetet që janë në lizing. Me rastin e lidhjes së sigurimit për këto raste, duhet dëshmuar se mjeti motorik është në lizing.
12. Tek mjetet motorike të siguruara me lizing, ndaj të siguruarit (Lizingut), nuk aplikohen shkallët e sistemit bonus-malus, ku në këtë rast kriteri të premisë merret shfrytëzuesi i Lizingut. Varësish nga shfrytëzuesi, nëse është person fizik shkalla e sistemit bonus-malus llogaritet si tek personat fizik, e në rast se është person juridik merret për bazë mjeti motorik.
13. Në rast të shkaktimit të aksidentit të automjetit me lizing, shkallët e malusit sipas nenit 3, pika 8 do të aplikohen për vozitësin-shkaktar të aksidentit si dhe për mjetin motorik përkatës.
14. Dispozitat për bonus-malus të përcaktuara me nenin 3, paragraf 8 të këtij udhëzimi, aplikohen edhe për mjetet motorike të personave juridik privat.
15. Ndryshimi i të dhënavës në aplikimin e sistemit bonus-malus, do të bëhet pas dërgimit të kërkuesës zyrtare zhvilluesit të këtij sistemi.
16. Në rastin kur personi juridik i siguruar, rëspektivisht vozitësi përkatës dëshmon me vendim të plotfuqishëm të gjykatës se nuk është përgjegjës për shkaktimin e aksidentit, nga siguruesi në mënyrë retroaktive do të shqyrtohet pozicioni i të siguruarit në shkallën bonus-malus dhe do të aplikohet sipas përllogaritjes së re.

### Neni 5

#### Përcaktimi i shkallës në sistemin Bonus-Malus varësisht nga vonesa për renovimin e sigurimit të autopërgjegjësisë

Në harmoni me rregulloren për zbatimin e sistemit bonus-malus (miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës me 12 qershor 2020), pavarësisht nga përkufizimet në nenet e mësipërme, aplikimi i shkallës së sistemit bonus malus për kontraktimin e sigurimit, do të varet edhe nga vonesa në renovimin e sigurimit.

Me rastin e kontraktimit të sigurimit, shkalla e bonus-malus do të aplikohet si më poshtë:

- Nga 10 ditë para skadimit të sigurimit të vitit paraprak deri në ditën e skadimit të sigurimit: Shkalla e aplikuar e bonus-malus do të jetë po ajo e fituar përmes historikut te dëmeve të të siguruarit. Pra nëse nuk ka aksident, minus një shkallë, nëse ka dëm të deklaruar plus 3 shkallë.
- Vonesa në renovim të sigurimit nga 1 deri në 15 ditë: Nuk do të ketë bonus të vitit të fundit të fituar, pra shkalla e bonus-malus do të mbetet e njejtë sikur në vitin paraprak. Megjithatë, nëse gjatë vitit paraprak është deklaruar dëm, malusi prej +3 shkallë do të aplikohet.
- Vonesa në renovim të sigurimit mbi 15 ditë:
  - Nëse klienti është në shkallë të bonusit: Do zhvendoset direkt në shkallën bazë. Nëse ka dëm të deklaruar atëherë shkalla bazë do të jetë penalizimi për vonesë në renovim të sigurimit dhe 3 shkallë të tjera si pasojë e dëmit të deklaruar.
  - Nëse klienti është në shkallën bazë apo të malusit: Klienti lëvizë +2 shkallë në shkallën e malusit.
- Si rregull e përgjithshme, së pari aplikohet kriteri i vonesës në sigurim, pastaj ai i dëmeve.

### Neni 6

#### Masat ndëshkuese

Shkeljet e dispozitave të këtij udhëzimi do të janë subjekt i masave ndëshkimore, në pajtim me nenin 37 të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

### Neni 7

#### Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me 01.11.2020.



Agim Elshani

Kryesues i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve

Byroja Kosovare e Sigurimit

